

Përmbledhje

1. **Emri i Trajnimit** : “ Përfshirja qytetare në vendimmarrjen publike”
2. **Data e trajnimit**: 28/03/2017
3. **Qyteti ku u zhvillua trajnimi** : Durrës
4. **Vendi ku u zhvillua trajnimi**: Qendra CSDC (Civil Society Development Center), Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile.
5. **Trajner**: Mirjam Reçi, Drejtoresha Ekzekutive e CSDC Durrës
6. **Qellimi dhe objektivat e trajnimit** : Informimi mbi mekanizmat për pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrjen lokale, kuadri ligjor ku rregullohet e drejta e pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje.
7. **Pasqyrë mbi pjesëmarrësit**

Nr. i pjesëmarrësve	19
Pozicioni	Anëtarë të CSDC Durrës, Vullnetarë pranë CSDC Durrës, Drejtoresha e Qendrës, “Gruaja në Fokus”, anëtarë të “ Gruaja në Fokus”, Kryetarja e Shtëpisë së Jetimëve, Dega Durrës, anëtarë të Shoqatës “ Shpresa e Jetimëve”; avokatë dhe studentë
Gjinia	15 femra dhe 4 meshkuj
Reagimi i pjesëmarrësve	Aktivë maksimalisht.

8. **Diskutimet kryesore nga pjesëmarrësit :**

- Kontrata Sociale me krye bashkiakun dhe përgatitja e kontratës sociale, marrëveshjes së mirëkuptimit me kandidatët për deputet.
- Punë në grup ku u adresuan me anë të mekanizmave të grumbullimit dhe kërkesës me shkresë zyrtare dhe peticion të problematikave:
Përfundimi i ndërtimit të kampusit universitar, ndërtimi i pikave të informacionit për turistët, procedurat burokratike për bizneset sezonalë, grumbullimi i mbetjeve në Porto Romano, etj

Ditën e martë, më datë 28.03.2017, u zhvillua në Qytetin e Durrësit, trajnimi mbi “Pjesëmarrjen Qytetare, në Vendimmarrjen Publike” me pjesëmarrës, Anëtarë të CSDC Durrës, Vullnetarë pranë CSDC Durrës, Drejtoresha e Qendrës, “Gruaja në Fokus”, anëtarë të “ Gruaja në Fokus”, Kryetarja e Shtëpisë së Jetimëve, Dega Durrës, anëtarë të Shoqatës “ Shpresa e Jetimëve”; avokatë dhe studentë.

Trajnimi u përqendrua në shembujt nga bota dhe praktikat e mira si dhe parimet dhe dispozitat kushtetuese nga e cila, buron kjo e drejtë.

Pjesëmarrësit në trajnim ishin shumë aktivë dhe të angazhuar në diskutime, të cilët zhvilluan punë në grup për trajtimin e një çështjeje dhe adresimin e saj në qeverisjen vendore.

